



Prishtinë: 11.11.2010

Kodi i ZRRE-së: V_305_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_481_10_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 14.6 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_481_10_10**;
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2010 nxori këtë:

VENDIM

PRANOHET ankesa e konsumatorit Arif Hyseni, (parashtruesi i ankesës Bekim Hyseni, shifra e konsumatorit DPR – 202618) nga fshati Komoran, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të 04.03.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 04.03.2009, lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 09.06.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë ndërruar njehsorin elektrik, ku kanë hequr njehsorin elektrik nr. 32411758 dhe kanë vendosur njehsorin elektrik nr. 6148011.
Provë: Vërtetimi mbi heqjen dhe ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 0195 të datës 09.06.2007
- Me datë 18.11.2008 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin teknik të njehsorit elektrik nr. 32411758 dhe kanë konstatuar se vulat (bllombat) shtetërore i ka të falsifikuara, sistemi i fazës T është i eliminuar, numëruesi ka regjistru energji elektrike për 33.3 % më pak, numëruesi i manipuluar.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr.16/13 të datës 13.07.2007
- Me datë 24.07.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse.
Provë: Procesverbali nr. 0145265 të datës 24.07.2008

- Me datë 07.08.2008 KEK-u e ngarkon konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR08HP06453 në vlerë prej 5,354.12 €.

Provë: Fatura e KEK-ut DPR08HP06453 e datës 07.08.2008
- Pas kësaj konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.

Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 20.02.2009 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin e kontrollës.

Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 30.01.2009
- Me datë 04.03.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 08.12.2009 DMK në pajtim me paragrafin 14.3 të nenit 14 të Rregullit mbi Procedurën për Zgjidhjen e Kontesteve në Sektorin e Energjisë, ka analizuar ankesat e konsumatorëve dhe ka vlerësuar se zyrtarët e autorizuar për inspektimin e pikave matëse gjatë përpilimit të procesverbaleve nuk kanë shënuar shumat e fuqive të shpenzuesve të inventarizuara me rastin e inspektimit të pikave matëse tek konsumatorët komercial dhe industrial ka kthyer në rishqyrtim lëndën e konsumatorit. Sipas kësaj KEK-u ka vepruar në kundërshtim me Nenin 12 të Procedurës së Përkohshme për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar.

Provë: Dokumenti i DMK për rishqyrtimin e ankesave të konsumatorëve
- Me datë 21.05.2010 Komisioni i KEK-ut në përbërje të stafit përgjegjës të operatorit të rrejtit dhe furnizuesit publik, ka refuzuar prapë ankesën e konsumatorit.

Provë: Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 21.05.2010

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ Pasi që DMK e ka dërguar lëndën e konsumatorit në rishqyrtim në KEK, punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me datë 09.03.2010 kanë bërë regjistrimin e pajisjeve elektrike.

Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 260151 të datës 09.03.2010
- ✓ KEK-u pasi ka marrë pajisjet elektrike të regjistruara në procesverbalin nr. 260151 të datës 09.03.2010, ka bërë edhe llogaritjen e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Sipas llogaritjeve të bëra nga KEK-u rillogaritja e ngarkesës për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike del me vlerë negative.

Provë: Llogaritja e KEK-ut për shfrytëzim të paautorizuar
- ✓ Komisioni i KEK-ut pasi ka marrë lëndën e konsumatorit në rishqyrtim, ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe ka refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se: *“konsumatorit njehsori nr. 32411758 sipas procesverbalit nr. 0195 i është ndërruar me dt. 09.06.2007. Ky njehsor është dërguar në shërbimin e kalibrimit dhe me dt. 13.07.2007 është përgatitur procesverbali i kontrollimit detal nr. 16/13 sipas të cilit: njehsori pllombat shtetërore i ka të falsifikuara, sistemi i fazës T është i eliminuar, numëruesi ka regjistru 33.33 % më pak, numëruesi i manipuluar. Vërejtje: Fatura interne në bazë të cilit llogaritet fatura e RH, sipas*

Proc. Perk. Për idenë. Dhe paran. Duhet të bazohet në pajisjet të cilat i furnizon pika matëse e jo në kabllin furnizues siç është llogaritur RH. Njehsori është prodhim i viti 2002. RH është llogaritur 100 % e jo 33.3. Rillogaritja e RH me pajisje sipas procesverbalit të kontrollës rezulton me vlerë negative – 864.85 €. Pajisjet nuk kanë mundur të evidentohen për shkak të ndërrimit të hapësirës së objektit. Vendimi i komisionit: Dënimi meritor pasi numëruesi i manipuluar”.

Provë: Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 05.05.2010

- ✓ Komisioni i KEK-ut në vendimin e tyre pas rishqyrtimit të lëndës së konsumatorit ka refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se: në bazë të fakteve nga procesverbali nr. 16/13 dt. 13.07.2007 dhe sipas parametrave të paraqitura në procesverbalin nr. 145265 dt. 24.07.2008 konstatohet se fatura nr. DPR08HP06453 dt. 07.08.2008 në vlerë 5,354.12 € është llogaritur konform nenit 12 të procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. RH është kalkuluar 100 % pasi përveç që sistemi T është eliminuar edhe numëruesi ka qenë i manipuluar. Për shkak se konsumatori ka ndërruar hapësirën e objektit nuk mund të bëhet regjistrimi i pajisjeve. Rillogaritja e RH sipas Procesverbalit të kontrollës nr. 006534 dt. 15.03.2005, ku si parametër është marrë fuqia instaluese 3 kW, rezulton me vlerë negative (-864.85 €).
- ✓ KEK-u edhe përkundër asaj që DMK ka kthyer në rishqyrtim ankesën e konsumatorit dhe i ka konstatuar se KEK nuk ka vepruar sipas nenit 12 të procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, KEK-u prapë ka refuzuar ankesën e konsumatorit, duke mos e marrë për bazë shkeljen e procedurës.
- ✓ Me datë 15.03.2005 punëtorët e KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se konsumatori ka bërë shtëpinë e vet lokal, ky harxhues të kalon në 0.4 kV në ekonomi prej amvisërisë, fuqia 3 kW.
Provë: Procesverbali nr. 006534 të datës 15.03.2005
- ✓ Sipas rrjedhës së energjisë aktive vërehet se prej periudhës 04/2004 e deri në periudhën 09/2005, nuk ka fare shpenzim të energjisë elektrike; prej periudhës 01/2003 e deri te periudha 03/2004 ka shpenzim të energjisë elektrike të evidentuar nga KEK-u por që në të sumtën e rasteve ka faturim pa matje – paushall. Konsumatori ka filluar të faturohet me rregull nga periudha 10/2005 dhe ajo vërehet edhe në rrjedhën e energjisë aktive si dhe në transaksionet e konsumatorit. .
- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike gjatë sezonës verore me njehsor të vjetër nr. 32411758 prej periudhës 04/2006 – 09/2006 është 580 kWh/muaj, ndërsa me njehsor të ri nr. 6148011 prej periudhës 04/2008 – 09/2008 është 2733 kWh/muaj.
Provë: Rrjedha e energjisë aktive
- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike gjatë sezonës dimërore me njehsor të vjetër nr. 32411758 prej periudhës 10/2006 – 03/2007 është 1050 kWh/muaj, për periudhën 10/2005 – 03/2006 është 753 ndërsa me njehsor të ri nr. 6148011 prej periudhës 10/2007 – 03/2008 është 962 kWh/muaj, prej periudhës 10/2008 – 03/2009 është 2488 kWh/muaj.
Provë: Rrjedha e energjisë aktive
- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës 10/2005 e deri te largimi i njehsorit elektrik periudha 09.06.2007 ka qenë 1003 kWh/muaj (të regjistruar në njehsorin e vjetër nr. 32411758), ndërsa mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës

08/2007 e deri te periudha 05/2009 është 2630 kWh/muaj (të regjistruar në njehsorin e ri nr. 6148011). Sipas kësaj analize shihet se ka rritje të konsumit të konsumatorit me njehsor të ri se sa me njehsor të vjetër.

Provë: Rrjedha e energjisë aktive

- ✓ Sipas listave të leximit (librit të leximeve) të KEK-ut, lexuesi KEK-ut në periudhën 05/2005 ka evidentuar njehsorin nr. 32411758; lexuesi i KEK-ut në periudhën 06/2005 ka evidentuar se nuk ka harxhim, në periudhën 10/2005 ka evidentuar njehsorin nr. 32411758; në periudhën 12/2006 ka evidentuar njehsorin nr. 32411758; në periudhën 01/2007 ka evidentuar njehsorin nr. 32411758; në periudhën 03/2007 ka evidentuar njehsorin nr. 32411758 dhe ka evidentuar se mungon vula distributive; në periudhën 06/2007 ka evidentuar se ka ndërrim njehsori; në periudhën 07/2007 ka evidentuar njehsorin nr. 32411758 se nuk ka çasje; në periudhën 09/2007 ka evidentuar njehsorin nr. 6148011.

Provë: Listat e leximit të KEK-ut

- ✓ Sipas analizave të bëra dëshmime vërehet se KEK-u në rishqyrtimin e tyre komisioni i KEK-ut ka theksuar se KEK-u ka ngarkuar konsumatorin 100 % e jo 33% për arsyet se përveç sistemit T i cili ka qenë i eliminuar, numëruesi ka qenë i manipuluar. Pasi që KEK-u ka marrë për llogaritje fuqinë e evidentuar në procesverbalin e KEK-ut nr. 15.03.2005 dhe ka zbritur energjinë e faturuara, rilogaritja e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar ka rezultuar me vlerë negative. Në procesverbalin e KEK-ut nr. 260151 të datës 09.08.2010 punëtorët e KEK-ut kanë theksuar se konsumatori nuk posedon njehsorin nr. 6148011 pasi që ka vendosur njehsorin nr. 44059620, sipas punëtorëve të KEK-ut në këtë objekt ka pasur katër njehsor, tani objekti është i bashkuar në tërësi dhe se nuk mund të ndahen shpenzimet e njehsorit elektrik.

- ✓ Punëtorët e KEK-ut me rastin e ndërrimit të njehsorit elektrik me datë 09.06.2007 në vërejtjen e tyre kanë konstatuar se dyshohet në vulën (bllobën) e djathtë të hjekur, këputur dhe se nuk kanë konstatuar se njëra fazë është e larguar.

Provë: Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 0195 të datës 09.06.2007

- ✓ Sipas deklaratës së konsumatorit theksohet se njehsorin elektrik e kanë vendosur punëtorët e autorizuar të KEK-ut gjatë vitit 2002 dhe se nuk ka pasur asnjë vërejtje nga ana e KEK-ut asnjëherë e as nga ekipet e kontrollës së KEK-ut.

Provë: Deklarata e konsumatorit

DMK duke u bazuar në analizat e cekura më lartë dhe dëshmitë e paraqitura, ka rekomanduar Bordin e ZRRE-së që të **pranojë** ankesën e konsumatorit dhe të vjen në përfundim se:

1. KEK-u duhet të shkarkojë konsumatorin nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DPR08HP06453 në vlerë prej 5,354.12 €, e datës 07.08.2008.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet dhe argumentet e paraqitura dhe pas analizës së lëndës së konsumatorit ka vendosur që ta **pranojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

- 1 Të shkarkojë konsumatorin nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DPR08HP06453 në vlerë prej 5,354.12 €, e datës 07.08.2008.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimi të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar